

VENDIM
Nr. 10, datë 21.3.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 46, DATË 19.9.2016 “PËR SHPËRNDARJEN
E FINANCIMIT PËR PROJEKTE RAJONALE, THIRRJA I PËR VITIN 2016, TË DREJTIMIT
“KOHEZIONI TERRITORIAL DHE ZHVILLIMI RAJONAL”, TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”, PROGRAMI “ZHVILLIMI I
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE”, SHTYLLA I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 46, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte rajonale, thirrja I për vitin 2016, të drejtimit “Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal”, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I” bëhen ndryshime, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Urban, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Në tabelën nr.1 të vendimit nr.46, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte rajonale, thirja I për vitin 2016, të drejtimit “Kohezioni teritorial dhe zhvillimi rajonal”, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale”, shtylla I”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Tabela 1. Lista e projekteve të reja për financim, thirja I për vitin 2016, drejtimi “Kohezioni teritorial dhe zhvillimi rajonal, nëpërmjet granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e “kursyer” pas lidhjes së kontratës (në lekë)
QARKU TIRANË						
1	AZHR 2	Stimulum me interes turistik dhe promovim i ngritjes së interesit turistik-kulturor, si shtigjet, udhët dhe itineraret turistike, në zonën Pellumbas-Shën Gjergj- Mali me Gropa-Bizë (Tiranë) dhe Gur i Bardhë-Lugina e Vashës (Klos) (Përfitues Bashkia Tiranë dhe Bashkia Klos)	20 000 000	20 000 000	18 445 320	1 554 680
QARKU KORÇË						
2		Sistemim asfaltim rruge kryqëzimi i rrugës Korçë-Bilisht (fshati Kuc)-Fshati Oman (Përfitues Bashkia Maliq dhe Bashkia Korçë)	183 410 345	183 410 345	105 014 148	78 396 197
TOTALI			203 410 345	203 410 345	123 459 468	79 950 887

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues, për zbatimin e punimeve të projektit mbas lidhjes së kontratës dhe “korrekton” vlerën e projektit.
3. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e shpërndarë si financim për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
4. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës” përfaqëson vlerën e përfituar nga diferenca ndërmjet vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, komunikuar nga Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.1744, prot., datë 17.3.2017 Fondi i krijuar nga kjo diferencë përfshihet në grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, për vitin 2016 dhe kërkohet miratim i Ministrisë së Financave për “trashëgimin” dhe përdorimin e tij në vitin 2017.

